

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE SH.P.K

NIPT L71710039A

Nr.1373 Regj
Nr.5964 Prot

Tiranë, më 09.11.2020

URDHËR
"PËR HEQJEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"

Drejtuar : Qendra Kombetare e Biznesit ✓
Adresa : Tirane
Per dijeni : Tre Vellezerit Shpk me NIPT K31519060G
Adresa : Farke LUNDER Rruga Tufa, Ndertesa nr 29, nr 31, Tel: 0682046089
Per dijeni : Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Adresa : Rr. "Myslym Keta", Tiranë

Unë, Resul Alushani me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Shoqërisë së Përmbarimit Privat "REAL BAILIFF SERVICE" Sh.p.k. në referim të Urdhrit të Ekzekutimit Nr. 597 date 15.07.2020 te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr. 1373 Regj, Datë 06.10.2020 kërkesën e kreditorit Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ndaj Tre Vellezerit Shpk me NIPT K31519060G, në lidhje me titullin ekzekutiv, "Proces-Verbal Inspektimi dhe Vendimi Perfundimtar Nr. AKU-TR-2018-002892-2-5 date 23.08.2018".

Pas kryerjes se Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të detyrimit dhe fillimit te ekzekutimit te detyrueshëm, referuar neneve 517 dhe 527 të K.Pr.Civile, me Shkresën Nr. 3748 Prot, datë 26.10.2020 është dërguar Urdhër për Vendosjen e Sekuestros Konservative në QKB.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOVA:

Se pas verifikimeve te llogarive bankare rezulton se detyrimi eshte ekzekutuar teresisht.

Në këto kushte, referuar nenit 616 Pika (a) të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 32, Pikat (b,c) të Ligjit Nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ:

1. Heqjen e masës së Sekuestros Konservative, të vendosur me anë të shkresës Nr. 3748 Prot, datë 26.10.2020 mbi aktivet e pales debitore Tre Vellezerit Shpk me NIPT K31519060G, me qellim mostjetersimin tyre, si dhe mos kryerjen çdo veprimi qe do te sillte ndryshime ne regjistrin tregtar.
2. Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.
3. Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhri do të merren masat e parashikuara në nenin 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vënd do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

ZYRA PERMBARIMORE PRIVATE REAL BAILIFF SERVICE
PËRMBARUESI GJYQËSOR
RESUL ALUSHANI

